# DËSHMI ARKIVI

**A-439688**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Hull City shtang Premier League, në vendin e tretë me djalin e një legjende që frenoi Chelsea |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/13/hull-city-shtang-premier-league-ne-vendin-e-trete-me-djalin-e-nje-legjende-qe-frenoi-chelsea/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 12:06:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 12:02:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 12:01:00 UTC → 13 shtator 2026, 12:03:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9288fb929fd3a2fc9127039eb459005f08f0bda097a0c113703629d6cb8c6ef0` |
| TEKSTI | `42ba549f03efcb33049d9711948e1a7c21ead7e47a91c6c4c3c69e3cddc22ff8` |
| PAMJA | `6cafc46359255da78f84fc01f7e7978c93bba190eae85b736e2955ed3db1c262` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `14403886319a03ac0ae1ab403a1bd84fe8367d46d1009bd4306ae414cae056d9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `ffe3484a9a9000951d0319deb7eab25f99edd91b8ae32dfd23370158c045acee` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/14403886319a03ac0ae1ab403a1bd84fe8367d46d1009bd4306ae414cae056d9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Hull City shtang Premier League, në vendin e tretë me djalin e një legjende që frenoi Chelsea

13/09/2026 14:02




**Vetëm përpara një viti dukej i destinuar të zbriste në Divizionin e Tretë, por në fakt erdhi ngjitja në elitën e futbollit anglez, Premier League në playoffin e Wembley. Por përralla e Hul City është e destinuar të vazhdojë. Një prej arkitektëve të kësaj skuadre është Sergej Jakirovic, një trajner kroat që nuk i përket ajkës së trajningut evropian.**

Basti i vënë nga drejtuesit e klubit ishte të besonte te dikush që kishte vetëm një eksperiencë në Turqi me Kayserispor, pas një sërë pankinash në Kroaci duke arritur kulmin me Dinamon e Zagrebit.

U zgjodh nga Hull City në verën e vitit 2025 dhe që nga ai moment mund të mburret me një ngjitje mrekulli në Premier League për të bërë një start të sezonit të jashtëzakonshëm duke befasuar çdokënd. Ditën e debutimit madje mposhti Manchester United duke krijuar menjëherë një pështjellim në kampionain më prestigjioz anglez. Të kthyer pas 9 vitesh në kategorinë më të lartë të futbollit anglez, futbollistët e Jakirovic bënë mrekullinë duke i mposhtur Djajtë e Kuq me rezultatin 2-0. Protagonisti i madh dhe autori i golit të dytë ishte Nobel Mendy, senegalezi që u transferua në sesionin e fundit të merkatos dhe që kushtoi 25 milionë euro. Një tjetër protagonist i madh i suksesit ndaj skuadrës së Michael Carrick dhe fillimit të shkëlqyer të sezonit është edhe portieri grek Konstantinos Tzolakis.

Por historia më sugjestionuese është e lidhur me algjerianin Mohamed Bachir Belloumi, autori i dygolëshit vendimtar në ndeshjen me Chelsea në Stamford Bridge. Ata që kanë pasur fatin e mirë për motive futbollistike dhe fatin e keq për ato të lidhura me moshën, për të ndjekur Botërorin e 1982, me siguri e kujtojnë të atin e futbollistit aktual të Hull City, Lakhdar Belloumi, që pas asistit të Allah Rabah Madjer, ishte autori i golit të fitores së Algjerisë ndaj Gjermanisë Perëndimore në fazën e grupeve, arritja më e madhe e futbollit afrikanoverior, pas vendit të katërt të Marokut në Botërorin e 2022.

Tani djali i tij është një prej pikave të forta të Hull City. Përveç dygolëshit ndaj Chelsea, ai nuk mund të përkufizohet një goleador por një sulmues i majtë që mund të luajë në të dy krahët, i shpejte, i zhgdërvjellët dhe i zoti edhe në dribling.

**Top Channel**

## Futboll »







**SPORT • KRYESORE**



Elbasani në kërkim të “thyerjes së mallkimit”, Vllaznia kërkon “shërim” në Laç, gjithçka rreth dy finaleve të sotme



Shokon tenistja ukrainase Yastremska: Një raketë ruse më shkatërroi shtëpinë



Frikë për djalin e Paolo Maldinit, përfshihet në një aksident me makinë pak orë pasi shënoi golin e fitores në Serie A



Elena Rybakina është mbretëresha e US Open, mposhti Sabalenkën në finale



Nuk luajnë më, por fitojnë miliona, lista e sportistëve më të pasur pas pensionimit

**ME TË LEXUARAT**

Frikë për djalin e Paolo Maldinit, përfshihet në një aksident me makinë pak orë pasi shënoi golin e fitores në Serie A

“Hiqi të gjitha, më pëlqen ngjyra blu”/ Kapet mat ish-futbollisti i

13/09 11:50 13/09 11:42

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/"Vetë Zot, vetë shkop", pagat e magjistratëve, Rama: Askush nuk mund të kërcënojë askënd



Top News- Rama u kthehet gjykatësve për pagave: Kërcënime e pengmarrje askush nuk duhet të bëj



Top News – Mesazh hakmarrjeje ndaj një gruaje/ Atentat në Mat, makina bëhet shoshë me plumba



Top News- Konstituohet Kuvendi i Kosovës/ PDK nuk merr pjesë, zgjidhet Tanja Vujoviçit nga serbët



Top News- Operacion shpëtimi spektakolar në Iran? CNN: Hegseth detyroi pilotët e F-15 të...



Top News-Kontroll makinave luksoze në Vlorë/ Sekuestrohen tre mjete, nis hetimi pasuror për pronarët




**© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.